

P. nr.60/2016

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve J. M. nga fshati U. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 të KPRK-ës, dhe të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-ës, kundër të akuzuarit Sh. M. nga fshati U. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës, dhe kundër të akuzuarit A. N. nga fshati L. K. P., për shkak të veprës penale të sulmit, nga neni 187 par. 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.1070/2015 të datës 25.01.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën **07.04.2017**, në prani të Prokurores së shtetit Mone Sylja, të akuzuarve, të dëmtuarit D. N. të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**1.I** akuzuari **J.M.**, nga i ati J. dhe e ëma S. e gjinisë B., i lindur me .... në fsh. U. K. Gjakovë, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, me profesion bukëpjekës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**2.I** akuzuari **SH. M.** nga i ati J. dhe e ëma S. e gjinisë B. i lindur me....në fsh. U. K. Gjakovë, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-babë i 2 fëmijëve, me profesion bukëpjekës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**3. I** akuzuari **A. N.** nga i ati V. dhe e ëma Z. e gjinisë D. i lindur me ..... në fsh. L. K. Prizren, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, i martuar-babë i 4 fëmijëve, me profesion bukëpjekës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**I akuzuari J. M. :**

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:**

**I.** Me datën 13.08.2015, rreth orës 14.05 minuta, në fshatin R. K. Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor ashtu që ditën kritike pas një mosmarrëveshje paraprake lidhur me mos blerjen e inventarit të furrës në shumën prej 21.000 Euro mes të akuzuarit J. M. dhe të dëmtuarve A. N. , B. N. dhe D. N. nga fshati L. K. Prizren, i akuzuari J. e godet me një bisht sopate në shpinë dhe kokë të dëmtuarin A. gjersa i njëjti kishte zënë gjatë kacafytjes përfundi vëllaun e të akuzuarit përkatësisht Sh. M., me ç’ rast i shkakton lëndime të lehta trupore të konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U. e dt.22.09.2015.

- me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 të KPRK-ës.

**II.** Me datë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin nën I të kësaj Aktakuze, i akuzuari J. me grushta dhe shqelma e godet të dëmtuarit B. dhe D. N., duke iu shkaktuar edhe

gërvishtje në qafë, me ç' rast të dëmtuarit pësojnë lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U. e dt.22.09.2015.

- me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës.

**I akuzuari Sh. M. :**

### **Ë s h t ë f a j t o r**

**III.** Me datë 13.08.2015 rreth orës 14.05 minuta në fshatin R. K. Gjakovë, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër ashtu që me grusht dhe shqelma e sulmon në kokë dhe trup të dëmtuarit B. dhe D. N., me ç' rast të njëjtëve ju ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U. e dt.22.09.2015.

- me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës.

**I akuzuari A. N. :**

### **Ë s h t ë f a j t o r**

**IV.** Me datë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e I të kësaj aktakuze, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër ashtu që me grusht dhe shqelma i sulmon të dëmtuarit J. dhe Sh. M. në kokë dhe trup, me ç' rast tek të njëjtit ka përdorë forcë dhe dhunë fizike.

-me çka ka kryer veprën penale, të sulmit, nga neni 187 par. 1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17,41, 49, 50, 51, 73, dhe nenit 188 par.2 të KPRK-ës, dhe nenit 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, iu shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

**1.**Të akuzuarit **J. M.** – për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-ës, të përshkruar si në dispozitivin e **I-rë** të aktakuzës i shqipton dënim me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **5(pesë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës, të përshkruar si në dispozitivin e **II-të** të aktakuzës i shqipton dënim me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

**Në kuptim të nenit 80 par.2 pika 2.2 të KPRK-ës, i shqiptohet dënimi unik me kusht duke vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(Gjashtë)muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1(Një)viti, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.**

**2.**Të akuzuarit **Sh. M.** – për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 të KPRK-ës, të përshkruar si në dispozitivin e **III-të** të aktakuzës i shqipton dënim me kusht,

duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

**3. Të akuzuarit A. N.**– për shkak të veprës penale të sulmit, nga neni 187 par.1 të KPRK-ës, të përshkruar si në dispozitivin e **IV-të** të aktakuzës i shqipton dënim me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

Detyrohen të akuzuarit J. M., Sh. M. dhe A. N. që secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **30,00.-Euro**, dhe në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguajnë shumën prej **50.-Euro**, në mënyrë solidare, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit B. N. dhe D. N. nga fsh. L. K. Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1070/2015, të datës 25.01.2016, kundër të akuzuarve J. M. nga fsh. U. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe veprës penale në bashkëkryerje të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, kundër të akuzuarit Sh. M. nga fsh. U. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, të sulmit, nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe kundër të akuzuarit A. N. nga fsh. L. K. Prizren, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të sulmit, nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit Mone Sylja pasi lexoi aktakuzën bënë përmisimin e kualifikimit të veprës penale të përshkruar në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, ashtu që hiqet fjala bashkëkryerje dhe neni 31 të KPRK-ës, dhe mbetet neni 188 par.2 të KPRK-ës, për veprën penale të përshkruar në pikën e I të dispozitivit të aktakuzës, mbetet neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës të përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, gjithashtu bëjë përmisimin e kualifikimit të veprës penale të përshkruar në pikën III të dispozitivit të aktakuzës, ashtu që në vend të veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, duhet të jetë vepra penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës, gjithashtu bëjë përmisimin e kualifikimit të veprës penale të përshkruar në pikën IV të dispozitivit të aktakuzës ashtu që hiqet fjala bashkëkryerje dhe neni 31 të KPRK-ës, dhe mbetet vetëm neni 187 par.1 i KPRK-ës, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari **J. M.** lidhur me fajësinë në shqyrtimin fillestar deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në pikën e I dhe të II të dispozitivit të aktakuzës të përmisuar nga ana e prokurores, shton se për këto vepra jam penduar pa masë dhe premtoi se në të ardhmen nuk do ta përsërisë të njëjtën, këto vepra penale i kam kryer në afekt duke mos menduar për pasojat e kryerjes së veprës, pas këtij rasti kemi kërkuar falje njërit tjetrit, ia kemi falur gabimin, jemi pajtuar sipas traditave tona, shton se jam njeri i punës, punoi në furrë, kontribuo në familje, mbajë familjen, prandaj i propozoi Gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë, sepse familja ime mvaret nga puna ime.

I akuzuari **Sh. M.** lidhur me fajësinë në shqyrtimin fillestar deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e III të aktakuzës të përmisuar nga ana e prokurores, kjo është hera e parë që kam kryer një veprë të tillë, por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, unë

jam njeri familjar, njeri i punës, jam baba i dy fëmijëve, jam mbajtës i familjes, shton se pas këtij rasti sipas traditave tona kemi kërkuar falje njërit tjetrit, ia kemi falur gabimin dhe prej atij rasti nuk kemi pasur mosmarrëveshje në mes veti, andaj i propozoi Gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të dënimit.

I akuzuari A. N. lidhur me fajësinë në shqyrtimin fillestar deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e IV të aktakuzës të përmysuar nga ana e prokurores, kjo është hera e parë që unë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale, por premti se do të jetë edhe hera e fundit, unë jam baba i katër fëmijëve, jam mbajtës i vetëm i familjes, e tërë familja mvaret nga puna ime që e kryej, si dhe sipas traditave tona ne jemi pajtuar në mes veti dhe prej atij momenti nuk kemi pasur mosmarrëveshje në mes veti, andaj i propozoi Gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të dënimit.

I dëmtuari D. N. deklaroi, se nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve J. M., Sh. M. dhe A. N., unë si palë e dëmtuar deklaroi se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensimin e dëmit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari J. M. ; Me datën 13.08.2015, rreth orës 14.05 minuta, në fshatin R. K. Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor ashtu që ditën kritike pas një mosmarrëveshje paraprake lidhur me mos blerjen e inventarit të furrës në shumën prej 21.000 Euro mes të akuzuarit J. M. dhe të dëmtuarve A. N., B. N. dhe D. N. nga fshati L. K. Prizren, i akuzuari J. e godet me një bisht sopate në shpinë dhe kokë të dëmtuarin A., gjersa i njëjti kishte zënë gjatë kacafytjes përfundim vëllaun e të akuzuarit përkatësisht Sh. M., me ç' rast i shkakton lëndime të lehta trupore të konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U. e dt.22.09.2015 si dhe me datë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin nën I të kësaj Aktakuze, i akuzuari J. me grushta dhe shqelma e godet të dëmtuarit B. dhe D. N., duke iu shkakuar edhe gërvishtje në qafë, me ç' rast të dëmtuarit pësojnë lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U. e dt.22.09.2015.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari Sh. M. ; Me datë 13.08.2015 rreth orës 14.05 minuta në fshatin R. K. Gjakovë, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër ashtu që me grusht dhe shqelma e sulmon në kokë dhe trup të dëmtuarit B. dhe D. N., me ç' rast të njëjtëve ju ka shkakuar lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U. e dt.22.09.2015.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. N. : Me datë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e I të kësaj aktakuze, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër ashtu që me grusht dhe shqelma i sulmon të dëmtuarit J. dhe Sh. M. në kokë dhe trup, me ç' rast tek të njëjtit ka përdorë forcë dhe dhunë fizike.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht

nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve; janë njerëz familjar, njerëz të punës, gjendjen e tyre ekonomike, pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në Gjykatë, pendimin e tyre dhe premtimin se në të ardhmen se nuk do të përsërisin të njëjtën, kërkim faljen, pajtueshmërinë e tyre në mes veti, i dëmtuari D. N. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensimin e dëmit, e sidomos faktin se të akuzuarit për herë të parë ndeshen me ligjin, më parë nuk kanë qenë të dënuar, si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tyre penale, motivet e kryerjes së veprës, andaj Gjykata të akuzuarit J. M. i shqiptoi dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale, të akuzuarit Sh. M. dhe A. N. secilit veç e veç iu shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe shpenzimeve të procedurës penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.60/16 më datë 07.04.2017**

**Sekretarja juridike,  
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.